

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i Fjalimit të Xhumasë i Kalifit të V^{të} të Xhematit Islamik Ahmedia, Hazret Mirza Masrur Ahmedit mbajtur në Qendrën e Xhematit 'Baitus-Subuh' në Frankfurt të Gjermanisë, më

29 dhjetor 2006

Hazuri¹ e filloi fjalimin e tij duke thënë se kam ardhur kësaj here në Gjermani me ftesën e Amirit² tuaj. Ai ka shprehur dëshirën që unë t'i inauguroja xhamitë që janë ndërtuar në vendin tuaj gjatë këtij viti. Ai më kishte ftuar më herët, por unë i pata thënë se do të prisja deri në dhjetor, kur do të vija edhe për të vënë gurëthemelin e disa xhamive të tjera. Dua t'i them Amirit dhe Xhematit të Gjermanisë se premitimi i tyre ka qenë të ndërtonin 5 xhami para se të vija pët t'i inauguruar, por deri tani janë ndërtuar vetëm tri prej tyre.

Ardhja ime këtu për këto inaugurime nuk do të thotë se jam i kënaqur me arritjet tuaja. Në fakt, qëllimi kryesor i ardhjes sime në Gjermani kësaj here është vënia e gurëthemelit të xhamisë së Berlinit. Ndërtimi i Xhamisë së Berlinit është një sfidë për Xhematin tonë. Duke i pasur parasyshtë rrethanat e tanishme si dhe për arsye historike, ky qytet ka rëndësi të veçantë për mua.

Kalifi i II^{të} ka pasur një dëshirë të madhe për të ndërtuar një xhami në Berlin. Siç e dini edhe ju, ai e kishte filluar projektin dhe kishte tubuar kontributet e nevojshme, por për shkak të rrethanave të disfavorshme, ato para më vonë u shpenzuan për ndërtimin e Xhamisë 'Baitul Fadhël' të Londrës. Për ndërtimin e Xhamisë së Berlinit, kontributet ishin mbledhur nga gratë e Xhematit dhe këtë e kishin bërë me sakrificë të jashtëzakonshme. Në atë kohë, gratë e Indisë, apo më mirë të themi gratë e Kadijanit, i kishin mbledhur 100 mijë rupi dhe ia kishin dhënë Kalifit të II^{të}. Kjo në atë kohë ishte një shumë e madhe të hollash.

¹ Kalifi i Xhematit Ahmedia

² Kryetar i Xhematit Ahmedia të një shteti.

Kryesisht, këto ishin sakrifica të grave të varfëra të Kadijanit. Nganjëherë ato sillnin disa pula ose ndonjë dhi që kishte apo disa enë të kuzhinës. Kalifi II^ë duke e kujtuar atë kohë thotë se kur apelova për grumbullimin e fondeve për Xhaminë e Berlinit, u duk një pasion i paparë te gratë e Xhematit, sa që ato dëshironin të jepnin gjithëçka që kishin në shtëpi. Një grua i dha të gjitha stolitë që kishte, por meqë ishte një grua e varfër dhe stolitë e saja ishin të pakta, ajo tha se dëshironte të sillte edhe gjithëçka tjetër që kishte në shtëpi. Kur burri i saj u ankua ajo i tha atij se po të ishte e lejuar do të të shisja edhe ty për xhami. Kjo tregon pasionin dhe entuziazmin atyre grave. Njeriu magjepset duke parë sakrificat e tyre.

Krahasoni për një moment sakrificat e atyre grave me kontributet tuajat në këtë kohë kur situata juaj ekonomike është shumë më e mirë. Kjo natyrisht është e pa krahasueshme. Sot ju, thjeshtë nuk mund të tregoni të njejtën gatishmëri në sakrifica të cilën e tregonin ata njerëz. Para pak kohësh mora një letër nga kryetari i 'Ansarullahut'³ të Xhematit tuaj në të cilën shkruhej se për ndërtimin e 100 xhamive në Gjermani 'Ansarullahu' ka premtuar 500 mijë Euro, por për shkak të disa shpenzimeve të paparashikueshme tani gjendemi në një situatë të palakmueshme dhe kërkojmë nga Qendra një hua që të mund t'i përmbushim premtimet tona. Unë u thashë se ju nuk duhet të dëshironi për këtë, sepse kjo nuk është shprehi e mirë për t'u përvetësuar. Një shprehi e tillë do të ju pengoj gjatë gjithë jetës. Ju duhet të shpenzoni brenda mundësive tuaja. Më vonë nuk e di se si ia bënë, por i përmbushën premtimet e tyre. Unë gjithashtu iu thashë se sa herë që dikush do të më kërkojë hua, do t'i pëgjigjem në të njejtën mënyrë, nëse insistojnë, s'më mbetet rrugë tjetër vetëm t'u them ahmedianëve pakistanezë që t'u ndihmojnë këtyre vëllezërve të pasur sepse janë duke e humbur kurajon.

Fjalën e pata te Xhamia e Berlinit e cila për mua ka një peshë dhe rëndësi të madhe. Tani, pas përafërsisht 86 vitesh, kur situata është më e favorshme, ne insha'allah, do ta ndërtojmë xhaminë tonë në këtë qytet. Pas bashkimit të dy Gjermanive dhe rënies së murit të Berlinit, Allahu ka krijuar një situatë të atillë që na mundëson plotësimin e dëshirës sonë të kahmotshme për ndërtimin e Xhamisë sonë atje. Prandaj, ju duhet të mundoheni të përfitoni nga situata relativisht e favorshme dhe duhet të filloni sa më parë me ndërtimin e Xhamisë. Shpresoj se më 2 janar, me emër të Allahut, do ta vëmë gurëthemelin e Xhamisë në Berlin. Kërkoj nga ju, dhe përmes MTA^{sa} nga të gjithë ahmedianët e botës që të luteni që Allahu ta mbaj situatën të favorshme, në mënyrë që ndërtimi i xhamisë të mund të fillojë me kohë. Lejen për ndërtim e kemi marrë nga komuna, por ndër banorët lokal është një pjesë që është duke e kundërshtuar fuqishëm ndërtimin e xhamisë. Para disa muajsh, kur u mblodh këshilli i udhëheqësve lokal, ata nuk lejuan që seanca të të zhvillonte punimet dhe e kundërshtuan aq kokëfortësisht sa që njerëzit

³ Organizatë në kuadrin e Xhematit e anëtarëve mbi moshën 40 vjeqare.

mezi arritën të largoheshin prej aty shëndosh e mirë. Prandaj, ju duhet të luteni shumë.

Kur para disa muajsh, Amiri juaj më takoi në Londër, ishte shumë i brengosur dhe nuk po mund të vendoste se a do të ishte më mirë që ta vëja unë gurëthemelin e xhamisë apo si t'ia bënim. Atëherë unë i thashë se, insha'allah, unë do ta vë gurëthemelin dhe nuk do ta shtyj vizitën time atje për shkak të situatës së krijuar dhe Allahu do të na ndihmojë. Këta njerëz janë një grup të marrësh; dhe ç'mund të bëjnë veçse të hedhin ca gurë mbi ne; dhe gjëra të tilla nuk duhet të jenë pengesë në rrugën tonë. Amiri tha se ata nuk hedhin gurë por domate. Sidoqoftë, organizatorët janë pak të brengosur. Por, nëse për një qëllim kaq të lartë siç është ndërtimi i shtëpisë së Allahut ku do të madhërohet emri i Tij dhe përhapja e mesazhit të dashurisë e të paqes së Islamit, nëse në këtë rrugë do të përjetojmë ca vështirësi, s'prish punë. Unë jam shumë i sigurtë se ai Zot që na ka mbrojtur nga problemet dhe fatkeqësitë deri tani, do të na mbrojë edhe në të ardhmen, insha'allah dhe do të na mundësojë ta kryejmë me sukses këtë punë.

Normalisht, populli gjerman nuk është kaq ekstrem si ky grup në Berlin. Ata janë një grup nacistësh dhe natyrisht se të tillë ka në të gjitha vendet e botës. Në Gjermaninë Lindore, për arsye të njohura reagimi i tyre është më i ashpër dhe ata janë më jotolerantë. Pika e dytë fatkeqe është se disa sekte muslimane, me aktivitetet e tyre antiahmediane e kanë keqësuar situatën. Këta të fundit në asnjë mënyrë nuk janë të gatshëm t'i pranojnë ahmedianët si muslimanë. Në të vërtetë, në këtë kohë janë vetëm ahmedianët ata që janë duke e mbrojtur Islamin. Ata, me anë të mësimëve të bukura të Islamit janë duke përhapur dashuri dhe paqë në botë.

Prandaj, gjatë procesit të ndërtimit të xhamive ju duhet t'u shmangeni situatave të padëshirueshme, por nëse situata të tilla ju imponohen, atëherë duhet të tregoheni të durueshëm dhe tolerantë. Në fjalimin tim të djeshëm unë e citova një revelatë të Mesihut të Premtuar^{ass} i cili ka thënë se neve na është urdhëruar që të përmbahemi dhe të tregohemi të durueshëm; dhe Allahu do të krijoj lehtësi për ne.

Kur në Angli u vu gurëthemeli i xhamisë sonë në Hartlepull, u paraqitën disa të rinj antiislamistë dhe gjuajtën gurë e thyen disa gjama. Por shembulli i anëtarëve tanë dhe përgjigja pozitive ndaj këtyre incidenteve pati efekt shumë pozitiv te banorët e atyshëm dhe si rezultat, ata pas një kohe filluan të na mbështesnin dhe të na dilnin krah. Elhamdulillah, tani të gjithë kanë vetëm fjalë të mira për ne dhe na falënderojnë duke na thënë se ju e keni larguar përshtypjen e keqe që kemi pasur kundrejt Islamit. Pra, edhe kjo përshtypje që është krijuar këtu në Gjermani, me kohë do të zhduket dhe lagohet. Por, ju duhet të përpiqeni që t'ua përqoni mesazhin e Islamit atyre dhe kjo është detyra juaj. Ju duhet t'u shpjegoni atyre se

ne jemi duke e ndërtuar këtë xhami sipas modelit të asaj shtëpie e cila ishte e para shtëpi e Allahut në tokë dhe e cila u ndërtua nga Hazret Ibrahim dhe djali i tij Hazret Ismaili. Ata, duke i hedhur themelet e saj luteshin: **“O Zoti ynë! Na bëj ne dhe pasardhësit tanë të nënshtruar ndaj vullnetit Tënd dhe na mëso mënyrën e flijimit”**.

Ata gjithashtu u lutën: **‘Rabbana takabal minnaa. Innaka Anta samiul aliim’**. ‘O Zoti ynë pranoje lutjen tonë dhe pranoje flijimin tonë’. Xhamitë tona janë në gjurmët e atyre xhamive të lashta. Dhe kjo xhami do të shpërndajë mesazhin e paqes dhe do të përpiqet të krijoj një atmosferë dashurie dhe vëllezërie në mes të njerëzve. Prandaj, nuk duhet të keni frikë prej nesh. Ju do ta shihni se nga kjo xhami do të dalin adhurues të vërtetë të Allahut. Prej aty drita e mësimëve të sheriatit të fundit do të përhapet. Prandaj, ju nuk duhet të keni frikë nga ne.

Ne jemi ata që dëshirojnë ta largojnë frikën prej njerëzve. Ne jemi të gatshëm të sakrifikojmë për vendosjen e paqes në tokë. Ne jemi ata që i injorojmë të drejtat tona për t’i mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Ky, pra është mesazhi që duhet t’ua jepni banorëve të këtushëm. Por, për këtë ju duhet të bëni ndryshime pozitive në veten tuaj dhe atëherë do ta shihni se nga mesi i tyre, njerëzit e mirë do të ngriten në mbrojtjen tuaj, siç e kemi provuar një gjë të tillë edhe më parë në këtë vend dhe në vendet tjera.

Në disa krahina të Gjermanisë ku i kemi ndërtuar xhamitë tona, të njejtit njerëz që protestonin kundër nesh, tani bashkëpunojnë me ne. Pra, nëse sinqerisht do të sakrifikoni dhe do të përpiqeni, atëherë jo vetëm një, por edhe shumë xhami të tjera do të ndërtohen në Berlin. Por kushti është që me sinqeritet të plotë të sakrifikoni në rrugën e Allahut, duke iu lutur Atij me përlulje që t’i pranojë prej nesh këto sakrifica të vogla. Dhe jo, që për t’i përmbushur premtimet tuaja të kërkonte hua nga Xhemati. Në botë ka shumë xhemate të varfëra të cilët kanë nevojë për ndihmën tonë dhe nëse ne do t’u japim ndihma juve që qëndroni mirë materialisht, atëherë shumë xhami që janë duke u ndërtuar në botë, shumë shtëpi misionesh, puna predikese, botimi i literaturës etj, nuk do të mund të bëhen. Pra, ju duhet të mundoheni të qëndroni në këmbët tuaja, të bëheni të pavarur dhe duhet të sakrifikoni duke u lutur që Allahu t’i pranojë sakrificat tuaja dhe të ju mundësojë të sakrifikoni edhe më shumë. Sakrificë është ajo e cila bëhet duke e lënë veten keq. Elhambulillah, në Gjermani ka anëtarë që e kanë arritur këtë nivel, por mbetet edhe shumë për t’u dëshiruar në disa fusha tjera. Sakrifica e pasurisë dhe e jetës suaj do t’i fitoj zemrat e këtushme.

Në kohën e Mesihut të Premtuar^{ass} në këtë vend kishte njerëz që kishin dëgjuar për të dhe misionin e tij dhe që i merrnin seriozisht pohimet e tij. Po të mos na pengonte situata e disfavorshme dhe përtacia jonë, suksesi do të kishte qenë shumë më i madh. Por tani u mbetet juve që t'i zgjidhni këto probleme. Tani unë do ta përmend një letër që një grua gjermane ia kishte dërguar Mesihut të Premtuar^{ass} në vitin 1907 dhe që ishte raportuar në revistën Al-Bader të po atij viti. Kjo grua quhej Karolinë. Ajo i shkroi Mesihut të Premtuar^{ass} se për shumë muaj me radhë jam duke e kërkuar adresën tuaj që të mund të të shkruaja. Më në fund e gjeta dikë i cili e dinte atë. - Adresa që i ishte dhënë asaj ishte "Në Kadijan, Krahina e Kashmirit, Indi"; edhe kështu e kishte arritur Kadijanin. - Ti je ai njeri i ngritur nga Zoti që je në shpirtin e Jezusit. Unë jam e interesuar në problemet e Indisë dhe në fe. Më vjen keq për kundërshtimin me të cilin po përballeni. Gjithashtu më vjen keq që njerëzit në vendin tuaj i adhurojnë ende idhujt atje me të madhe. Unë jam gjermane ndërsa burri im është anglez. Ju jeni duke e adhuruar Zotin në mënyrë të drejtë. Shpresoj se dini anglisht. Nëse keni mundësi, ju lutem më dërgoni fotografinë tuaj. Dhe më thoni se a mund të bëj ndonjë shërbim për ju në këto anë. Duhet të jeni të sigurtë se unë jam mike juaja e sinqertë.

Kjo letër ishte shkruar në një kohë kur komunikimi nuk ishte i lehtë dhe në Gjermani nuk kishte asnjë ahmedian. Zoti e di se prej nga ajo e mori atë adresë. Sot ju jeni në mijëra në Gjermani. Ju predikoni dhe jeni duke ndërtuar xhami. Megjithëse bota është më shumë e anuar nga materializmi dhe e larguar nga feja, por ata gjithashtu kanë shqetësimet e tyre të cilat ju duhet të përpiqeni t'ua largoni dhe duhet t'ua tregoni bukuritë e Islamit. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se nëse dëshironi ta përhapni Islamit në krahinën tuaj, atë mund ta bëni vetëm me xhamitë tuaja. Prandaj ju duhet ta përhapni një rrjetë të tërë xhamishë i cili do ta bëjë predikimin tuaj më të lehtë. Prandaj, në këtë drejtim duhet të bëni njëpërpjekje të vazhdueshme. Mos u kënaqni vetëm me një xhami të vetme në Gjermaninë Lindore, ju duhet të mundoheni të ndërtoni edhe të tjera. Allahu na dhashtë mundësi për këtë.

Kalifi i dytë i Xhematit dëshironte të ndërtonte një qendër madhështore në Berlin, por për shkak të vështirësive të shumta dhe rrethanave të pavolitshme, ai e shtyu ndërtimin e xhamisë dhe vendosi që me fondet e destinuara për të, të ndërtohet një xhami në Londër e cila do të shërbente edhe si qendër për tërë Evropën dhe ky vendim u muar në mars të vitit 1924 kur edhe u mbyll përkohësisht misioni në Gjermani.

Sot, Allahu e ka bekuar Xhematin e Gjermanisë dhe krahas shumë xhamive të tjera tani po përgaditet për ndërtimin e Xhamisë së Berlinit. Ne duhet t'i jemi

mirënjohës Allahut për bekimet e shumta që na i ka dhënë. Ju duhet ta shpërndani mësimin e bukur të islamin ndër këta njerëz dhe mesazhi juaj, xhamitë tuaja dhe vetë ju duhet të bëheni simbol i paqes në këtë pjesë të botës. Nga minaret e Xhamive tona drita hyjnore të cilin Allahu ia ka zbritur Profetit të Shenjtë^{sas} duhet të shpërndahet. Nëse do të dështoni në përhapjen e këtij mësimi në këtë vend, do të dështoni edhe në detyrimin tuaj ndaj xhamisë. Ju duhet të jeni ndër ata që e kuptojmë qëllimin e ndërtimit të xhamive dhe detyrimet tuaja ndaj xhamisë. Allahu thotë: **“Ata të cilët e besojnë Allahun dhe botën tjetër, e falin namazin, e japin zekatin dhe nuk i frikësohen askujt pos Allahut, këta do të llogariten ndër të devotshmit”**.

Pra, ky duhet të jetë qëllimi i çdo ahmediani. Pa besim të plotë në Allahun, do të jetë pohim i rrejshëm se jemi duke e ndërtuar një shtëpi të Allahut. Cilat janë kushtet që Allahu i ka vënë për adhurimn e Tij? Të pohosh vetëm me gjuhë se beson në Allahun nuk është e mjaftueshme, por duhet të përmbushësh edhe disa kushte të tjera. Si për shembull Allahu thotë se besimtari duhet ta dojë Allahun më shumë se gjithçka tjetër. Tregëtia, pasuria, fëmijët dhe gjërat e tjera që i doni duhet të duken të parëndësishme përball dashurisë së Allahut. Vetëm për këta mund të thuhet se e besojnë Allahun. Ata janë mbi çdo lloj lakmie e dëshire dhe vinë në xhami vetëm për ta adhuruar Allahun. Dhe kur e dëgjojnë Emrin e Allahut duke u përmendur, zemrat e tyre dridhen. **“Idha dhukirall-llaahu, vaxhilat kulubuhum”**. Kur u shpjegohen atyre urdhërat e Allahut, ata u përgjigjen menjëherë atyre dhe frikësohen nga dënimi i Allahut po të mos binden.

Kam dëgjuar se disa - ndoshta një ose dy - i dëgjojnë fjalimet e mia me kujdes dhe janë të rregullt në tubimet e xhemitit, por nuk e shohin të arsyshme t’i praktikojnë ato që i dëgjojnë. Ata mendojnë se detyra e Kalifit është të na i tregoj kërkesat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, por unë do të bëj sipas dëshirës sime. Ky është një mendim shumë i gabuar. Këta njerëz duhet ta analizojnë besimin e tyre.

Një shenjë tjetër dalluese e besimtarit të vërtetë është se ai nuk është i kënaqur me gjendjen e tij prezente por bën përpjekje që çdo ditë të përparojë edhe më shumë në besimin e tij. Çdo ditë ata bëjnë ndryshime për të mirë në vetën e tyre. Një shenjë tjetër është, se kur thirren te Allahu dhe i dërguari i Tij, ata nuk thonë se kemi dëgjuar dhe do të vazhdojmë sipas dëshirës sonë, porse thonë **“Sami’na wa ata’na”** - Dëgjuam dhe u bindëm. Nëse edhe ju nuk e jepni këtë përgjigje atëherë, besimi juaj në Allahun nuk është i plotë.

Një shenjë tjerë e atyre që e besojnë Allahun është se ata pasi të kenë deklaruar se e besojnë Atë, nuk i marrin për miq kundërshtarët e Allahut dhe të Dërguarit të Tij

e as nuk shoqërohen me ta. Çfarë besimtari mund të jetë ai i cili nga njëra anë pohon se e ka besuar Imamin e Kohës dhe nga ana tjetër shoqërohet me ata që e kundërshtojnë këtë Imam të Allahut. Shenja e besimit është që ta duani Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe Xhematin e Tij më shumë se gjithëçka tjetër duke mos u ankuar pse ndodh kjo apo ajo gjë. Vetëm atëherë mund të llogariteni ndër besimtarët e vërtetë.

Ajeti që e recitova gjithashtu thotë se shenjë e besimtarit është se ai beson fuqishëm në jetën e paskësajme. Ai që e beson paluhatshëm ditën e gjykimit nuk mund të bëjë mëkate. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë: *“Cytjet e shejtanit janë të panumërta dhe më e rrezikshmja është dyshimi që ai krijon në zemrat e njerëzve rreth Ditës së Gjykimit dhe jetës së paskësajme. Sepse shkak i veprave të mira dhe frenimit nga mëkatet është besimi në jetën e ardhshme dhe nëse njeriu mendon se ky s’është gjë tjetër pos një trillim, atëherë do të ndjehet i lirë të veprojë sipas epshit të vet. Një njeri i tillë do të jetë i humbur në këtë dhe në botën tjetër. Sepse, është frika e dhënies së llogarisë para Zotit ajo që e mbushë zemrën e njeriut me frikë dhe e shpie gradualisht te burimi i vërtetë i diturisë hyjnore. Dhe dituria e thellë hyjnore nuk mund të fitohet pa frikën e Allahut”.*

Prandaj, duhet të keni kujdes, sepse dyshimet rreth jetës së ardhshme janë shumë të rrezikshme dhe u pamundësojnë një përfundim të mirë. Pra, ata që e kanë frikë Allahun ata do ta kenë diturinë e vërtetë hyjnore dhe ata do të përparojnë në devotshmëri dhe do t’i ngrisin standardet e adhurimit të tyre. Allahu e ka quajtur adhurimin e këtyre besimtarëve si adhurim të vërtetë dhe ata janë të denjë për t’i populluar xhamitë. Ata kur sakrifikojnë për ndërtimin e xhamive nuk mendojnë se i kanë bërë ndonjë nder të madh Xhematit me kontributin e tyre. Pas ndërtimit të Xhamisë ata gjithashtu kujdesen për popullimin e tyre. Ata janë të rregulltë në xhami për namazet e përbashkëta dhe janë gjithashtu të rregullt edhe në namazin e sabahut.

Pas dhënies së kontributeve tuaja për xhami, ju nuk jeni të lirë nga obligimi i zekatit. Duhet t’u kushtoni vëmendje zekatit dhe kontributeve të tjera. Nëse do të jeni të vëmendshën ndaj këtyre kontributeve, frika e Allahut do t’i mbizotëroj të gjitha frikat tjera dhe nuk do të bëni ndonjë gjë që do të jetë kundër Islamit dhe shariatit të tij dhe do t’i kryeni detyrimet tuaja ndaj Krijuesit dhe krijesave të Tij. Vetëm atëherë xhamitë tona do të jenë xhami të vërteta. Këta njerëz do të ndjellin bekimet e Allahut dhe do të jenë të suksesshëm në qëllimet e tyre. Me shigjetat e lutjeve të tyre i zbrapsin sulmet e armiqve. Për këtë qëllim ju duhet të ndërtoni xhami dhe t’i populloni ato. Aty do të mbillni për të ardhmen tuaj në këtë dhe në botën tjetër. Përndryshe, bota është plot me xhami, posaqërisht në kohën tonë kur

muslimanët e kanë shkatërruar imazhin e Islamit dhe në vend që të jenë pranues të bekimeve të Allahut, janë bërë pre e hidhërimit të Tij.

Transmetohet nga Hazret Aliu i cili e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: **“Do të vijë një kohë kur asgjë nuk do të mbetet nga Islami përveç emrit të tij, dhe asgjë nuk do të mbetet nga Kur’ani përveç tekstit të tij, xhamitë e asaj kohe, në dukje të populluara, do të jenë të zbrazta nga devotshmëria. Hoxhallarët e tyre do të jenë krijesat më të korruptuara nën kupën e qiellit. Të gjitha ngatërresat do të burojnë prej tyre dhe te ta do të kthehen”**. A nuk është kjo ajo kohë për të cilën ka folur i Dërguari i Allahut^{sas}? Ata në dukje e falin namaizn dhe i bëjnë ritualet tjera, por e injorojnë kushtin kryesor që Allahu e ka caktuar për besimin e vërtetë në këtë kohë, pra, të besuarit në Imamin e Kohës.

Neve Allahu na ka bekuar me këtë dhe në shenjë falënderimi ne duhet t’i përulemi dhe ta adhurojmë edhe më me përkushtim, në mënyrë që rrjedha e bekimeve të mos ndërprehet por të vazhdojë përgjithmonë. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë: *“Bukuria e xhamisë nuk qëndron në godinën e saj, por qëndron në adhuruesit e singertë të cilët e adhurojnë Allahun në të”*. Prandaj, sot kur ndërtojmë xhami të reja, duhet t’i ndërtojmë duke e patur këtë thënie të Mesihut të Premtuar^{ass} parasyshtë. Allahu na ndihmoftë të bëjmë kështu. Amin!

<p>Note: This is an Albanian translation of Hazoor’s Khutba of 29 December 2006 held in ‘Baitus-Sabuh’ - Frankfurt am Main, Germany. The main topic of this Khutba is The building of the Berlin Mosque</p>
--